

Karta Europiane e punës me të rinjtë në nivel lokal.

Një shoqëri demokratike ka nevojë për zërat dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve. Për të përmbushur këtë rol, të rinjtë kanë nevojë për një vend ku ata mund të përcaktojnë axhendën e tyre. Një hapësirë ku ata, së bashku me bashkëmoshatarët e tyre, mund të eksplorojnë, artikulojnë dhe zhvillojnë interesat dhe talentet, si dhe idetë e tyre për të ardhmen. **Një hapësirë ku ata marrin nxitje dhe mbështetje për të zhvilluar më tej njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që u duhen në mënyrë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë si individë dhe qytetarë.** Puna me të rinjtë është kjo hapësirë, dhe të rinjtë¹ janë dhe duhet të jenë gjithmonë aktorët kryesorë të saj. **Puna me të rinjtë është pra një proces i të mësuarit, jo vetëm për të rinjtë, por edhe për shoqërinë.** Është një investim i favorshëm sidomos për një shoqëri që synon përfshirjen dhe kohezionin shoqëror, ku puna me të rinjtë ka një rol të rëndësishëm



Qëllimet kryesore të punës me të rinjtë janë deklaruar në shumë dokumente kryesore të politikës si nga Bashkimi European, ashtu edhe nga Këshilli i Europës². Kjo kartë megjithatë, nuk është një dokument politik. Karta në fakt, i shndërron këto dokumente në udhëzime konkrete në lidhje me atë që nevojitet për të vendosur dhe mbajtur cilësinë në punën me të rinjtë në nivel lokal. **Ideja e një Karte filloi për herë të parë në Konventën e Dytë të Punës me të Rinjtë, e mbajtur në Bruksel në vitin 2015.** Në deklaratë, u shpreh se "Konventa po kërkon për më shumë ndërgjegjësim për këtë përgjegjësi të nivelit lokal dhe të dakordëshet me autoritetet rajonale për një Statut European për punën me të rinjtë në nivelin lokal". Motivimi ishte të krijonte një terren të përbashkët për punën me të rinjtë. Duke filluar nga deklaratat, 22 Agjencitë Kombëtare Erasmus + në fushën e Rinisë së bashku me partnerët e tyre, rrjeti InterCity, rrjeti POYWE, Forumi European i Rinisë dhe partneriteti midis BE-së dhe Këshillit të Europës, filluan projektin strategjik dhe bashkëpunues Europe Goes Local³. Karta është një prej rezultateve kryesore të këtij projekti. Është zhvilluar përmes një procesi konsultimi në të gjithë Europën, duke përfshirë një gamë të gjerë të palëve të interesuara në të gjitha nivelet si: qeveritë, komunat, OJQ-të, organizatat dhe këshillat rinor, organizatat ombrellë dhe shumë të tjerë.

Kështu pra, Karta është krijuar dhe i përket një komuniteti të gjerë european të punonjësve rinorë, dhe është në interes të të gjithëve, nga politikëbërësit te punonjësit me të rinjtë, e deri te vetë të rinjtë që janë të angazhuar në fushën e rinisë dhe dëshirojnë ta përmirësojnë atë.



Qëllimi i Kartës është të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të punës me të rinjtë në nivel lokal. Këtë e realizon duke theksuar se cilat parimet që duhet ta drejtojnë atë dhe, si duhen hartuar aspekte të ndryshme të tyre në mënyrë që të përmbushen këto parime. Prandaj, karta përbën një platformë të përbashkët europiane për dialogun e nevojshëm për punën me të rinjtë. Është një mjet metodologjik i lirë për t'u përdorur, që funksionon si një listë kontrolli rreth së cilës palët e interesuara mund të mblidhen dhe të diskutojnë se cilat masa mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të punës me të rinjtë, duke u siguruar që asnjë aspekt ose perspektivë të mos lihet jashtë dhe se ofrimi i punës me të rinjtë kryhet në mënyrën më të mirë dhe më efektive. Karta duhet të konsiderohet si një e tërë dhe çështjet kryesore nuk renditen sipas përparësisë, por sipas një rendi logjik.



Sidoqoftë, puna me të rinjtë karakterizohet nga larmishmëria e saj, jo vetëm në praktikë, por edhe në mënyrën e organizimit, planifikimit dhe financimit të saj. Edhe pse shumica dërrmuese e punës me të rinjtë ka pikënisjen e saj dhe zhvillohet në nivelin lokal, aktorë të ndryshëm në nivele të ndryshme janë përgjegjës për çështjet e ndryshme të renditura në këtë Kartë. Askush prej tyre nuk mund të plotësojë të gjitha kërkesat e Kartës në vetvete dhe askush prej tyre nuk mund të tërhiqet nga përgjegjësia. Në mënyrë që të mbështeten diskutimet për implementimin e kësaj Karte në realitete të ndryshme lokale, ajo shoqërohet nga një paketë mjetesh ndërvepruese online, e cila ofron perspektiva, shpjegime, dokumente referimi dhe shembuj të praktikave të mira lidhur me çështjet kryesore që Karta trajton.

¹ Megjithatë, të rinjtë nuk janë një grup homogjen. Ata kanë prejardhje, interesa dhe ide të ndryshme, mund të jenë të organizuar ose jo dhe do të kenë nevojë të ndryshme, për shkak të këtyre dhe ndryshimeve të tjera.

² Ndër këto dokumente janë:

- Përfundimet e Këshillit mbi kontributin e punës rinore cilësore në zhvillimin, mirëqenien dhe përfshirjen sociale të të rinjve (2013 / C 168/03)
- Axhenda 2020, Rezoluta CM/Res (2008) 23 mbi politikën rinore të Këshillit të Europës
- Rekomandimi i Këshillit të Evropës për Punën me Rininë (CM / Rec (2017) 4

³ Projekti financohet në kuadrin e Aktiviteteve të Bashkëpunimit Transnacional të programit Erasmus +

- ★ të bazohet në pjesëmarrjen vullnetare – tek ata të rinj që kanë zgjedhur të jenë aktivë në fushën e rinisë me dëshirën dhe motivimi e tyre të lirë;
- ★ të bazohet mbi dhe t'u përgjigjet nevojave, interesave, ideve dhe përvojave të të rinjve, siç perceptohen nga vetë ata, duke sjellë kështu një vlerë të shtuar dhe/ose gëzim në jetë;
- ★ të krijohet, organizohet, planifikohet, përgatitet, kryhet dhe vlerësohet sëbashku me të rinjtë ose nga vetë ata;
- ★ të kontribuojë në zhvillimin personal dhe social të të rinjve, përmes edukimit jo-formal dhe informal;
- ★ të përpiqet të përmirësojë tek ë rinjtë vendosmërinë, autonominë dhe aksesin ndaj të drejtave;
- ★ të ketë një qasje gjithëpërfshirëse për të rinjtë dhe t'i takojë ata atje ku janë, si individë të aftë dhe si burimi kryesor në vetë jetën e tyre dhe për shoqërinë në tërësi;
- ★ të promovojë mendimin kritik dhe kreativitetin, e njëkohësisht të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe qytetarinë aktive;
- ★ të jetë gjithëpërfshirëse në mënyrë aktive dhe të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë.



- ★ është zhvilluar:
 - brenda kornizës dhe në përputhje me parimet thelbësore të identifikuara më lart;
 - në bashkëpunim mes të gjithë aktorëve përkatës, përfshirë të rinjtë, duke pasur role dhe mandate të qarta dhe duke qenë të përfshirë në të gjitha fazat e procesit;
 - në bazë të njohurive të përditësuara mbi nevojat, të drejtat dhe interesat e të rinjve;
- ★ bazuar në studime dhe kërkime të reja, ashtu dhe në format dhe metodat e ndryshme të punës me të rinjtë që mund të përdoren për të përmbushur qëllimet dhe objektivat;
- ★ bazohet në tregues cilësorë dhe sasiorë të qartë dhe të matshëm mbi pritshmëritë mbi pjesëmarrjen, ndikimin dhe të mësuarit e të rinjve;
- ★ shpërndan burime të përshtatshme sipas qëllimeve;
- ★ përmban qëllime dhe objektiva të qarta dhe të aprovuara politikisht në nivel lokal, duke respektuar autonominë e organizatave joqeveritare lokale;
- ★ ka një pozicionim të qartë dhe është e ndërlidhur me politikat rinore në të gjitha nivelet, nga ato lokale në ato Europiane.



- ★ të përfshihen në dialog me të gjithë aktorët përkatës;
- ★ të shndërrojnë synimet dhe objektivat në strategji dhe plane koherente;
- ★ të përcaktojnë dhe vendosin parakushtet dhe proceset e punës së nevojshme për kryerjen e një pune cilësore me të rinjtë;
- ★ të shkëmbejnë vazhdimisht informacione në lidhje me planet dhe aktivitetet me aktorë të tjerë lokalë, kombëtarë dhe Europianë në fushën e rinisë, sikurse të angazhohet në mënyrë aktive në bashkëpunimin ndërmjet dhe brenda sektoreve;
- ★ të këshillojë dhe tu japë të rinjve akses në një gamë të gjerë informacioni të përshtatur në lidhje me të drejtat dhe mundësitë e tyre për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- ★ të nxisë dhe mbështesë të rinjtë:
 - të takohen pavarësisht çdo barriere dhe kufizimi, në mënyrë që të socializohen, shkëmbejnë përvoja dhe ide, të organizohen, të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të ndërveprojnë;
 - të jenë qytetarë aktivë dhe të ushtrojnë ndikim në shoqëri, duke përfshirë pjesëmarrjen në vendimmarrje politike;
 - të jenë të hapur ndaj botës dhe të angazhohen në mënyrë aktive në lëvizjen dhe bashkëpunimin rajonal, kombëtar, Europian dhe ndërkombëtar;
- ★ të artikulojnë, së bashku me të rinjtë, objektivat e të mësuarit që ata i perceptojnë si të rëndësishëm për zhvillimin e tyre personal dhe shoqëror;
- ★ të dokumentojnë dhe të bëjnë të dukshme rezultatet e të nxënës jo-formal dhe informal të të rinjve, si p.sh. njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat, të arritura përmes punës me të rinjtë dhe të mbështesin njohjen e kompetencave të arritura;
- ★ t'u sigurojë atyre që punojnë me të rinjtë informacion, arsim, trajnim dhe mbështetjen e nevojshme dhe të përshtatur me nevojat lokale të cilat mund të nxisin dhe mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave.



- ★ të veprojnë brenda një kornize të qartë etike, bazuar në parimet thelbësore të deklaruara më lart, ashtu dhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- ★ të drejtohen nga vullneti për të mbështetur të rinjtë në zhvillimin e tyre personal dhe social;
- ★ të krijojnë një mjedis të përshtatshëm dhe të besueshëm që është gjithëpërfshirës, fuqizues dhe angazhues, krijues dhe i sigurt, argëtues dhe serioz, i gjallë dhe i planifikuar;
- ★ të identifikojnë nevojën dhe të kërkojë mënyra për:
 - të angazhur të rinjtë në të gjitha fazat e procesit të punës me të rinjve;
 - të mbështesë të rinjtë për t'u vetë-organizuar;
- ★ të kenë kompetencat, (njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat) e nevojshme për kryerjen e punës me të rinjtë në përputhje me parimet dhe veprimet e përshkruara në këtë Kartë;
- ★ ta shohin punën e të rinjtë si një proces të të mësuarit të ndërsjelltë dhe të jenë të aftë të identifikojnë nevoja për zhvillim të vazhdueshëm të aftësive;
- ★ të jenë të vetëdijshëm dhe të aftë për të artikuluar rolin dhe misionin e punonjësve rinor dhe të mos bien pre e qëllimeve dhe aktiviteteve që dalin jashtë sferës së parimeve thelbësore;
- ★ të reflektojnë vazhdimisht dhe në mënyrë kritike se si veprimet e tyre, si dhe objektivat lokale, metodat dhe mënyrat e organizimit të veprimtarive, përputhen me parimet thelbësore.



- ★ një sistem të qartë dhe gjithëpërfshirës për dokumentimin dhe ndjekjen e rezultateve, parakushteve dhe proceseve të punës në lidhje me treguesit dhe qëllimet e matshme;
- ★ pasqyrim të rregullt dhe të përditësuar të realiteteve dhe nevojave lokale;
- ★ procedura të qarta për analizë të vazhdueshme dhe reflektim të rezultateve në lidhje me mënyrën se si ato lidhen me parakushtet, proceset e punës dhe aktivitetet, si dhe nevojën për zhvillim të mëtejshëm;
- ★ procedura të qarta për përditësime të vazhdueshme mbi kërkimet e reja kombëtare dhe ndërkombëtare, trendet dhe metodat në fushën e të rinjve dhe punës me të rinjtë;
- ★ përpjekjet e përbashkëta të të gjithë aktorëve për të bashkëpunuar rreth zhvillimit të cilësisë dhe adoptimit të inovacioneve;
- ★ zhvillimi të vazhdueshëm të kompetencave të punonjësve rinor bazuar në një kornizë të qartë të kompetencave në kombinim me një analizë të rezultateve lokale, nevojave, pikave të forta dhe atyre të dobëta.



PARTNERËT NË NIVEL KOMBËTAR



www.oead.at



www.erasmusplus-jeunesse.fr



www.leargas.ie



www.iuventa.sk



www.jint.be



www.jugendfuereuropa.de



www.jaunatne.gov.lv



www.movit.si



www.mobilnost.hr




erasmus-plus.gr



www.aha.li



www.anpcdefp.ro



www.ufm.dk



www.tka.hu



www.jtba.lt



www.mucf.se



www.agenziagiovani.it



www.rannis.is



www.erasmusplus.nl



www.oph.fi/fi/eun-nuoriso-ohjelmat



www.juventude.pt



www.dzs.cz



www.movetia.ch



www.aktivungdom.eu



erasmusplus.rs



europanoored.eu

ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE



pjp-eu.coe.int



www.youthforum.org



www.youthforum.org



intercityyouth.eu



www.poywe.org



www.salto-youth.net/rc/eeca/



www.salto-youth.net/see

“PUNA ME TË RINJTË
BAZOHET NË VLERA ...
DHE PROMOVON TË DREJTAT
E NJERIUT.”

